



UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Str. 'Xhorxh Bush', Rectorate Building, 10 000 Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Ref. no.: 1/260
Date: 4 / 5 / 2018

FTESË PUBLIKE

Për shprehje të interesit për monitorim të zgjedhjeve të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin 2018-2020

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datë 19.04.2018 mori vendim për shpalljen e zgjedhjeve të të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin 2018-2020.

Prandaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të studentëve të UP-së, fton të gjitha institucionet, organizatat, mediat dhe palët tjera për shprehje të interesit për monitorim të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor të zgjedhjeve të studentëve të Universitetin e Prishtinës.


Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve të studentëve të UP-ës bëhet në formë të shkruar dhe duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- Emrin e institucionit / organizatës;
- Dëshmi se është person juridik (Certifikatë për regjistrim të OJQ, certifikatë biznesi,
- Certifikatë TVSH për institucione etj)
- Emrin dhe mbiemrin e personit të interesuar për monitorim;
- Numri kontaktues, dhe
- E-mail adresën.

Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve dorëzohet në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së në ndërtesën e rektoratit. Aplikimi për monitorim bëhet me datë xx.xx.2018, ndërsa certifikimi dhe pajisja me ID-kartelë do të bëhet me datë xx .xx.2018 nga ora 14.00-15.00. Pas mbylljes së afatit për aplikim, KQZ nuk do të bëjë akreditimin e palëve të interesit për monitorim të zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të studentëve është i përkushtuar dhe angazhuar për një proces zgjedhor transparent, korrekt dhe të besueshëm siç i ka hije institucionit më të madh dhe më të vjetër të arsimit të lartë në Kosovë.

Ju mirëpresim!



Esat Kelmendi

Kryesues i KQZ-së për zgjedhjet e studentëve